



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:265026

Datë: 04.10.2024

Numri i dokumentit: 06251375

K.DH.SH.II.nr.1154/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, kryetar i kolegjit Faton Bajrami, Krenar Berisha dhe Dren Rogova, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Ipko Telecommunications” LLC me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson Isamedin Dedinca, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjyimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.46/24 të datës 02.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 03.10.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit “Ipko Telecommunications” LLC me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.46/24 të datës 02.04.2024, **Vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Dhoma e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative, me Aktgjykimin e ankimuar, e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar, kërkesëpadinë e paditësit, “Ipko Telecommunications” LLC, me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) me seli në Prishtinë, me të cilin ka kërkuar anulimin e vendimit nr.1112 të datës 30.01.2018 të paditurit dhe të detyrohet i padituri që t’ia paguaj shumën prej 152,500.00€ me kamatë ligjore duke filluar nga data 07.10.2010 deri në pagesën definitive. Ndërsa secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë paditësi, përmes të autorizuarit të tij, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të LKA-së, LPK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që ankesa e paditësit të miratohet si e bazuar, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.46/2024 i datës 02.04.2024, të ndryshohet ashtu që gjykata komerciale e Kosovës Dhoma e Shkallës së Dytë të gjykoj duke e miratuar kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të bazuar. Të anulohet vendimi i të paditurit Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve elektronike dhe postare ARKEP, vendimi nr.1112 i datës 30.01.2018 si i kundërligjshëm dhe të detyrohet i padituri Autoriteti Rregullativ i komunikimeve elektronike dhe postare ARKEP me seli në Prishtinë që paditësit IPKO Telecommunications LL.C me seli në Prishtinë t'ia paguaj shumën prej 152.500€ me kamatë ligjore e cila fillon të rrjedh nga data 07.10.2010 e deri në pagesën definitive në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet në ankesë, të paditësit, dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49 të LKA-së, dhe nenit 194, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, (LPK), (ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA), gjen se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me vendimin nr.1112 të datës 30.01.2018, në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi ka vendosur: I. Operatori "Ipko Telecommunications" LL.C" i shqiptohet sanksioni në shumë prej njëqind e pesëdhjetë e dymijë e pesëqind euro (152,500.00€ për shkak të mos zbatimit të vendimit nr.15 për përgjimet ligjore (nr. prot 32/10). Nën pikën II. Meqenëse "Ipko Telecommunications" LLC me datë 06.10.2010 ka ekzekutuar sanksionin ekonomik vetëm konfirmohet nga ARKEP dhe konsiderohet i ekzekutuar. Nën pikën III. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I pa kënaqur me këtë vendim paditësi, ka ushtruar padi në gjykatë, kundër të paditurit Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, duke pretenduar se vendimi i të paditurës është jo ligjor. Dhoma e Shkallës së Parë për këtë çështje mban seancë të shqyrtimit kryesor, më datë 12.03.2024, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit e në mungesë të përfaqësuesit të paditurës, dhe pas administrimit të provave si dhe shkresave tjera të lëndës bien aktgjykimin e ankimuar me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar. Me arsyetim se Gjykata ka vlerësuar se paditësi ka qenë ligjërisht i obliguar që ta përmbush vendimin nr. 15 të ndryshuar përmes vendimit nr. 29 të së Paditurit. Ligjshmëria e vendimit 15 është juridikisht e pakontestueshme, meqenëse ajo është vërtetuar me vendim të formës së prerë gjyqësor, ndërsa ligjshmëria e vendimit nr. 29 nuk është kontestuar asnjëherë. Pra, dispozitivi i vendimit nr. 15 ka paraqitur obligim juridikisht të vlefshëm për Paditësin. Në lidhje me çështjen se a ka vepruar paditësi sipas vendimit nr. 15 të ndryshuar me vendimi nr. 29, gjykata ka konstatuar se paditësi nuk e ka përmbushur obligimin e tij që ka rezultuar nga ai vendim. Siç është sqaruar më lartë, paditësi nuk e ka paraqitur asnjë provë se e ka përmbushur obligimin nga vendimi nr. 15 i ndryshuar me vendimin nr. 29. Përveç kësaj paditësi nuk ka ngritur pretendim se e ka përmbushur obligimin e tij. Në raport me çështjen e katërt, gjykata në rend të parë ka vlerësuar se, meqenëse për paditësin obligimi nga vendimi nr. 15 i ndryshuar me vendimin nr. 29 të së paditurit është krijuar në gusht të vitit 2010, atëherë gjykata ka gjetur se ligj i zbatueshëm është Ligjit nr. 2002/7 për Telekomunikacionin

i viti 2003, i ndryshuar përmes Ligjit nr. 03/L-085 për Ndryshimin e Ligjit Telekomunikacion të Miratuar nga Kuvendi i Kosovës i viti 2008, e jo Ligji 03/L-109 për Komunikimet Elektronike i vitit 2012. Sipas nenit 15 para. 5 të Ligjit nr. 2002/7 për Telekomunikacionin “Kur inspektorët kanë dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar se i licencuari ka bërë kundërvajtje ndaj këtij ligji, ndaj kushteve të licencës dhe/apo rregullave të miratuara, ART-i mund: a) të vendosë gjoba dhe lëshojë urdhra me shkrim për të përmirësuar veprimet e gabueshme brenda një periudhe të caktuar kohore; b) suspendojë apo revokojë autorizimet e përgjithshme apo licencën individuale”. Nga përmbajtja e këtyre dispozitave rrjedh se i padituri, dikur me emrin Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit (ART), ka pasur të drejtë që shqiptoj gjoba në rastet kur një subjekt i licencuar benë shkelje të rregullave të miratuara nga i padituri. Lartësia e gjobave ishte e rregulluar me udhëzimin administrativ nr. 2004/3 mbi Caktimin e Dënimeve nga Kundërvajtja nga Telekomunikacioni, i cili në nenin 3 para. 1 shkronja b) ka përcaktuar se “3.1 Personi juridik do të dënohet në shumë prej 100,000 deri 250,000 Euro nëse: (...) b) I licencuari nuk i përmbahet kushteve të licencës dhe rregullave të miratuara nga ART-ja si dhe masave tjera nga neni 15.5 pika a) dhe b);”, ndërsa në para. 2 të të njëjtit nen ka rregulluar se “Personi fizik i cili në mënyrë të pavarur zhvillon aktivitet apo personi përgjegjës i personit juridik i cili kryen shkeljet e paraqitura në nenin 3 paragrafi 1 të këtij Udhëzimi Administrativ, do të dënohet në një shumë prej 1,000 dhe 5,000 Euro”. Për këtë gjykatë, vendimi nr. 15 i ndryshuar me vendimin nr. 29 përfshihet në termin ligjor “rregulla të miratuara” të paraparë në nenin 15 para. 5 të ligjit të cituar më lartë, rrjedhimisht për mos zbatimin e detyrimit nga këto vendimi i Padituri ka qenë i autorizuar që të shqiptoj gjobë. Gjithashtu, gjykata ka vlerësuar se gjoba e shqiptuara janë brenda kufijve të përcaktuara me udhëzimin administrativ të sapo cituar. Gjykata ka vlerësuar si të pabazuar pretendimin e paditësit se me vendimin nr. 15 të së paditurit vetëm është aprovuar dokumenti kornizë i formatit të marrëveshjes, ndërsa nuk ka të bëjë fare me bazën ligjore me të cilin e ka detyruar paditësin që të lidh marrëveshje për përgjime me Policinë e Kosovës dhe e si pasojë e moszbatimit të këtij vendimi nuk ka pasur të drejtë të shqiptoj sanksione, meqenëse, siç është sqaruar edhe më lartë, me pikën 2 të dispozitivit të vendimit nr. 15 është caktuar edhe detyrimi për paditësin që të lidh kontratën e caktuar me Policinë e Kosovës. Prandaj, gjykata përfundimisht ka vlerësuar se vendimi i goditur është nxjerrë duke i respektuar dispozitat e procedurës administrative, organi administrativ e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, i ka zbatuar drejtë dispozitat materiale administrative, si dhe i padituri ka qenë organ kompetent për nxjerrjen e vendimit të tillë, rrjedhimisht nuk ka asnjë arsye ligjore që ai të anulohet. Meqenëse nuk është vërtetuar kundërligjshmëria e aktit administrativ të goditur, atëherë për këtë gjykatë nuk ekziston bazë ligjore nga neni 26 para. 2 nën para. 3 lidhur me nenin 46 para. 5 i LKA-së për kthimin e sendit të marrë, gjegjësisht kthimin e shumës prej 152,000.00€, meqenëse dispozitat e sapo cekura mundësojnë kthimin e sendit vetëm nëse anulohet akti administrativ i goditur.

Dhoma e Shkallës së Parë, duke u bazuar në nenin 13 par. 1, nën par 1.12 lidhur me par 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Qëndrimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA). Dhoma e Shkallës së Parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 43 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës ka gjetur se vendimi i të paditurës, është i ligjshëm i bazuar në fakte të dëshmuara në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, të theksuar si në aktgjykimin e ankimuar të cilin gjithashtu edhe kolegji e miraton si vendim të drejtë dhe ligjor.

Sa i përket pretendimeve ankimore për shkelje të dispozitave të LKA-së, pasi që Dhoma e Shkallës së Parë nuk ka vendosur në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, sepse nuk ishte kontestues fakti se vendimi i të paditurit në procedurë me nr.1112 i datës 30.01.2018 është nxjerr në kundërshtim të plotë me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.943/2010 të datës 19.01.2016, kjo për faktin se me këtë aktgjykim gjykata ka konstatuar dhe ka vlerësuar se me anulimin e vendimit nr.9 të paditurit i ka rënë baza juridike në të cilin e kishte mbështetur vendimin nr.30 për shqiptimin e sanksionit ndaj paditësit. Kolegji vlerëson se pretendimet ankimore janë të pa bazuara, për faktin se Dhoma e Shkallës së Parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar ku në bazë të provave të administruara është konstatuar se i Padituri me nxjerrjen e vendimit nr. 1112 të datës 30.01.2018 e ka zbatuar aktgjykimin A.nr.943/2010 të datës 19.06.2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, meqenëse me atë aktgjykim ishte anuluar vendimi nr. 30 i të Padituri, me të cilin gjithashtu ishte shqiptuar gjobë për mos përmbushjen e vendimit nr. 29, si pjesë e vendimit nr. 15 të së Paditurit. Andaj, sipas vlerësimit të kolegjit, aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së Shkallës së Parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë.

Lidhur me pretendimet ankimore se ekzistojnë shkeljet thelbësore të dispozitave të nenit 182 par 2 pika n) të LPK-së të cilat zbatohen përshtatshmërisht në procedurën e konfliktit administrativ, konsistojnë në faktin se aktgjykimi i atakuar ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, sepse dispozitivi dhe arsyetimi i këtij aktgjykimi janë në kundërrthënie me përmbajtjen e provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe këtij aktgjykimi i mungojnë arsyet mbi faktet vendimtare dhe se ekzistojnë kundërrthënie ndërmjet asaj që thuhet në arsyetim me përmbajtjen e provave. Këtë pretendim kolegji e refuzoi si të pa bazuar për arsye se aktgjykimi i atakuar me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe 2 pika n), ku përcakton se: “në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet, e sidomos në qoftë se dispozitivi është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjyqimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërrthënie midis asaj që në arsyet e aktgjyqimit – thuhet për përmbajtjen e dokumentit ose procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vetë atyre dokumenteve ose të procesverbalit” Kolegji vlerëson se aktgjykimi nuk është i përfshirë as në shkeljet e tjera të dispozitave të procedurës administrative e as me konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Ndërsa sa i përket pretendimit se Dhoma e Shkallës së Parë nuk ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike pasi që nuk i analizoi me kujdes provat një nga një dhe të gjitha së bashku sepse fillimisht nuk e ka analizuar me kujdes vendimin nr.9 i datës 22.02.2010 i të paditurit pasi që ky vendim (dhe jo vendimi nr.15 i datës 12.04.2010) paraqet bazën mbi të cilën janë obliguar operatorët e licencuar që brenda afatit prej 10 ditësh të nënshkruajnë marrëveshje formalo-juridike me Policinë e Kosovës lidhur me përgjimet dhe regjistrimin e bisedave telefonike, ndërsa ky vendim nr.9 është anuluar me aktgjykimin A.nr.313/10 të datës 26.02.2014 të formës së prerë në të cilin arsyetim gjykata vlerëson se nuk dihet se nga cili ligj apo dispozitë ligjore organi i paditur ka marrë autorizime për të vendosur obligime për paditësin (për nënshkrimin e marrëveshjes me Policinë e Kosovës) si në vendimin e kontestuar. Kolegji vlerësoj se pretendimi i paditësit është i pa bazuar pasi që Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit (ART), ka pasur të drejtë që shqiptoj gjoba në rastet kur një subjekt i licencuar benë

shkelje të rregullave të miratuara nga i padituri. Lartësia e gjobave ishte e rregulluar me udhëzimin administrativ nr. 2004/3 mbi Caktimin e Dënimeve nga Kundërvajtja nga Telekomunikacioni, Prandaj, Dhoma e Shkallës së Parë drejt ka vlerësuar ku ka konstatuar se obligimi nga vendimi nr. 15 i ndryshuar me vendimin nr. 29 të së Paditurit është krijuar në gusht të vitit 2010, atëherë ligj i zbatueshëm është Ligji nr. 2002/7 për Telekomunikacionin i viti 2003, i ndryshuar përmes Ligjit nr. 03/L-085 për Ndryshimin e Ligjit Telekomunikacion të Miratuar nga Kuvendi i Kosovës i viti 2008, e jo Ligji 03/L-109 për Komunikimet Elektronike i vitit 2012. Andaj, kolegji vlerëson se i padituri me vendimin nr. 15 i ndryshuar me vendimin nr. 29 ku përfshihen “rregulla të miratuara” të paraparë në nenin 15 paragrafi 5 të Ligjit nr. 03/L-085 për Ndryshimin e Ligjit për Telekomunikacion, rrjedhimisht për mos zbatimin e detyrimit nga këto vendimi i padituri ka qenë i autorizuar që të shqiptoj gjobë.

Mbi këtë gjendje të fakteve të provuara, kolegji konstaton se çështja në shqyrtim nga Dhoma e Shkallës së Parë, përkatësisht vlerësimi i ligjshmërisë së vendimit të organit administrativ përfundimtar është shqyrtuar në mënyrë të argumentuar në baza ligjore, andaj pretendimet ankimore kolegji i vlerëson jo me ndikim për tu vërtetuar gjendje tjetër faktike, dhe për të vendosur ndryshe nga ajo e vendosur në Dhomën e Shkallës së Parë.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.115424, me datë 03.10.2024

Kryetar i kolegjit,
Faton Bajrami